



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT**  
**DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK**

**Datë 14.10.2024**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shpenzime për shërbime promociionale të komunikimit dhe publikimit”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**79342200-5 Shërbime promociionale**

**Vlera e fondit limit:** 4. 415.333 (katërmilion e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”( ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

*b.Sigurimin e Ofertës,sipas Shtojcës 4; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës: **88,306.66 (tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë lekë pa TVSH, të lëshuar në formën e garancisë bankare, nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse ose pagese e kryer ne numrin e llogarise se Autoritetit Kontraktor.***

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se:*

*“...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”*

*“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.1.1** Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikaten ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e cila të përfshijë objektin e prokurimit (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO).

*Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.*

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

Kriteri që operatori ekonomik duhet të disponojë Certificate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që operatorët ekonomik disponojnë një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë të mallrave për të cilat ofertojnë. Menaxhimi i cilësisë i certifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.

ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanimit të njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të

jetë jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

**Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.**

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*Neni 43*

*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, ne procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

*KREU II*

*KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK*

1. *Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*

a) *Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000*

000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

**Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.**

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar

standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, germa b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

## **2.3 Për kapacitetin teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: 883,066(*tetëqind e tetëdhjetë e tremijë e gjashtëdhjetë e gjashtë*) lekë pa Tvsh .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashmetë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrateku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlloritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur

duhet të vërtetohet se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

**2.3.2** Operatori ekonomik për realizimin e shërbimit duhet të disponojë minimum 1 (një) paisje printer UV me bojë rezistente për hapësira të jashtme me mundësi printimi deri në 5m gjerësi për baner, banner mash. Paisja printer duhet të jetë në pronësi, me qera ose huapërdorje. Në rastin e pronësisë duhet vërtetuar me aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes dhe në rastin e qerave/huapërdorjes, duhet të paraqitet kontrata perkatese e qerave, ose huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues mbi disponimin e pajisjes, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar*

**2.3.3** Operatori ekonomik për realizimin e shërbimit duhet të disponojë minimum 1 (një) paisje printer për mundësi të printimit të copës flamur me gjerësi printimi deri në 3m. Operatori ekonomik për realizimin e shërbimit duhet të disponojë minimum 1 (një) paisje printer UV me bojë rezistente për hapësira të jashtme me mundësi printimi deri në 5m gjerësi për baner, banner mash. Paisja printer duhet të jetë në pronësi, me qera ose huapërdorje. Në rastin e pronësisë duhet vërtetuar me aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes dhe në rastin e qerave/huapërdorjes, duhet të paraqitet kontrata perkatese e qerave, ose huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues mbi disponimin e pajisjes, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

**2.3.4** Operatori ekonomik për realizimin e shërbimit duhet të disponojë minimum 1 (njw) paisje printer për printim të materialeve promocionale dhe të personalizuar. Paisja printer duhet të jetë në pronësi, me qera ose huapërdorje. Në rastin e pronësisë duhet vërtetuar me aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes dhe në rastin e qerave/huapërdorjes, duhet të paraqitet kontrata perkatese e qerave, ose huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues mbi disponimin e pajisjes, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

**2.3.5** Operatori ekonomik për realizimin e shërbimit duhet të disponojë minimum 1 (njw) paisje printer format dixhital për printim të broshurave, fletëpalosjeve. Paisja printer duhet të jetë në pronësi, me qera ose huapërdorje. Në rastin e pronësisë duhet vërtetuar me aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes dhe në rastin e qerave/huapërdorjes, duhet të paraqitet kontrata perkatese e qerave, ose huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues mbi disponimin e pajisjes, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

**Argumentimi:** Kriteri është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike të nevojshme për kryerjen e prodhimit të materialeve sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, me qëllim realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

2.3.6 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **15 (pesëmbëdhjetë) punonjës** për periudhën e **tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e **tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave**.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e **tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave**.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në funksion dhe në zbatim të kërkesave ligjore të Kodit të Punës. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë këtë numër punonjësish si për garantimin e zhvillimit të shërbimit pa ndërprerje ashtu edhe në zbatim të detyrimeve ligjore që kanë të bëjnë në kohën e punës së Punëmarrësve.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve, janë analizuar disa faktorë, përfshirë natyrën e shërbimit të objektit të kontratës, sasinë e materialit që do të prodhohet, dhe afatin 30 ditë kalendarike për realizimin e shërbimit. Numri i punonjësve është një element shumë i rëndësishëm për natyrën e këtij shërbimi, pasi kërkohet një staf i nevojshëm për zhvillimin dhe realizimin sa më të suksesshëm të kontratës.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, në të cilën angazhohet se merr përsipër transportin e mallit objekt prokurimi në ambjentet e magazinimit pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 pika 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar shërbimit që kërkohet të kryhet, atij të shërbimeve për realizimin e produkteve promocionale dhe të komunikimit, bazuar në termat e referencës dhe specifikimet teknike të hartuara nga Grupi i punës për Përcaktimin e fondit limit, duke qënë se ato, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, njësisia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për shërbimin objekt prokurimi.

**Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

### Termet e referencës përcaktuar sa më poshtë vijon:

a. **Baner MESH pa unaza me forçime me litar.**

- Prodhim materiali vinyl, i papërshkueshëm nga uji, rezistent ndaj erës dhe zbehjes, rezistent ndaj rrudhave dhe i fortë
- Për përdorim në ambiente të jashtme.
- Sasia: 50 m<sup>2</sup>
- Shembull:



b. **Prodhim Banner me litar e unaza me përforcime anësore**

- Prodhim materiali vinyl, i papërshkueshëm nga uji, rezistent ndaj erës dhe zbehjes, rezistent ndaj rrudhave dhe i fortë
- Për përdorim në ambiente të jashtme.
- Sasia: 50 m<sup>2</sup>





- Shembull:

c. **Prodhim promocional forex 10 mm + adeziv (të branduar) (të prerë).**

- Prodhim forex me trashësi 10mm, i papërshkueshëm nga uji, rezistent ndaj erës dhe zbehjes, rezistent ndaj rrudhave dhe i fortë.
- Për përdorim në ambiente të jashtme.
- Sasia: 100 m2

d. **Prodhim promocional forex 5 mm + adeziv (të branduar) (të prerë).**

- Prodhim forex me trashësi 5mm, i papërshkueshëm nga uji, rezistent ndaj erës dhe zbehjes, rezistent ndaj rrudhave dhe i fortë.
- Për përdorim në ambiente të jashtme.
- Sasia: 100 m2

e. **Prodhim roll up banner me mekanizëm (indoor)**

- Përmasat: Standarde 85 cm x 200 cm
- Madhësia grafike: 83 cm x 200 cm
- Materiali: Banner me mekanizëm alumin dhe çantë mbajtëse
- Sasia: 4 copë



f. **Prodhim 2 roll-up baner stand (outdoor)**

- Madhësia e banerit: 85 cm x 200 cm
- Madhësia grafike: 83 cm x 200 cm
- Materiali: Banner me mekanizëm alumin dhe çantë mbajtëse
- Përdorimi në natyrë
- Sasia: 2 copë




g. **Prodhim baner i gjerë 2515mm (ë) x 2540mm (h) me mekanizëm**

- Madhësia e banerit: 2515mm (ë) x 2540mm (h)
- Madhësia grafike: 2410mm (ë) x 2435mm (h)
- Materiali: Banner me mekanizëm alumin dhe çantë mbajtëse
- Përdorimi në natyrë
- Sasia: 2 copë



h. **Prodhim standë event i me adesiv reklamues**

- Standë event i me adesiv reklamues, me rafte nga brenda
- Përmasat e standës: 2200 mm lartësi, 900mm gjerësi, dhe thellesi 510mm
- Specifika të tjera: Dizajni i paketës së sheshtë, e çmontueshme me paketim, kokë pvc shkumë të bardhë dhe panel kundër polipropileni. E lëvizshme me rrota.
- Brandimi me adesiv
- Sasia: 2



- Shembull:

i. **Banner ëall media backdrop (me hark) outdoor approx: 3,75 x 2,25 m me brandim**

- Aksesorët përfshijnë një palë krahë (2 x 450 mm x 2250 mm)
- Procesi i tekstilit dhe i sublimimit: Lëkurat/Printet e Bannerëall Sublimohen me Ngjyrë mbi Bannerëeave ose Thick Ultrasteen dhe mbarohen me Velcro (50 mm) të qepura përreth për t'u përshtatur në kornizën e aluminit.
- Njësia e plotë përfshin: Baner/Print/Lëkurë, Kornizë alumini dhe çantë transporti.
- Sasia: 1 copë



j. **Banner ëall media backdrop (i drejtë) outdoor approx: 3,75 x 2,25 m me brandim**

- Aksesorët përfshijnë një palë krahë (2 x 450 mm x 2250 mm)
- Procesi i tekstilit dhe i sublimimit: Lëkurat/Printet e Bannerëall Sublimohen me Ngjyrë mbi Bannerëeave ose Thick Ultrasteen dhe mbarohen me Velcro (50 mm) të qepura përreth për t'u përshtatur në kornizën e aluminit.
- Njësia e plotë përfshin: Baner/Print/Lëkurë, Kornizë alumini dhe çantë transporti.
- Sasia: 1 copë



k. **Prodhim flamurë tekstil për kapje në shtyllë me përforsim anësor me brandim**

- CMYK me 4/0 ngjyra
- Banderola 110 gsm, përmasat e flamurit 4.0 x1.0m / 3.0 x.08m
- Përshtylla me konsolë
- Me brandim të dedikuar pa mekanizëm
- Sasia: 50 m<sup>2</sup>



1. **Prodhim flamurë Tekstil (Beach flag) me mekanizëm**

- 4.0 x1.0 m/ 3 x 0.8 m
- CMYK me 4/0 ngjyra
- Banderola 110gsm
- Brandim i përfshirë, me mekanizëm dhe bazament të përfshirë



- Sasia: 20 copë

m. **Prodhim flamurë banner të hollë me perforcime anësore dhe unaza, dhe brandim**

- Projektuar posaçërisht për shtyllë ndriçimi ose ndonjë shtyllë për banderolat.
- Materiali i kllapave: Alumini
- Materiali i brezit: çelik inox
- Materiali i banerit: Pëlhurë poliestër premium
- Printim dixhital me ngjyra të plota nga te dyja anët. Rezistent ndaj ujit, erës dhe rrezet UV.
- Sasia: 50 m<sup>2</sup>



Pole Flag Sizes

n. **Prodhim promocional adeziv i thjeshtë me brandime të ndryshëm**

- I përshtatshëm për stampim me bojë dhe pigment me rezolucion i lartë dhe tharje e shpejtë.
- Rezistent ndaj ujit, grisjeve papërshkueshme nga uji dhe, përdoret gjerësisht si për reklamat e jashtme ashtu edhe për ato të brendshme.
- Prerje dhe aplikim i lehtë mbi një shumëllojshmëri sipërfaqesh.
- Sasia: 100 m<sup>2</sup>

o. **Prodhim broshura/fletëpalosje A5 (2-3 palosje) materiale promocionale.**

- Rezolucioni: Imazhet dhe grafika duhet të kenë një rezolucion prej të paktën 300 dpi për të siguruar printim me cilësi të lartë.
- Modaliteti i ngjyrave: CMYK 4/0 është mënyra e preferuar e ngjyrave për materialet e printuara
- Sasia: 2000 copë

p. **Prodhim promocional në plexiglass 3mm**

- Printim apo gdhëndje në material plexiglass për promocione të ndryshme (outdoor)
- Sasia: 50 m<sup>2</sup>

q. **Prodhim promocional në plexiglass 5mm**

- Printim apo gdhëndje në material plexiglass për promocione të ndryshme (outdoor)
- Sasia: 100 m<sup>2</sup>

r. **Prodhim materiale promocionale - stilolapsa të ricikluar nga kartoni me brandime të dedikuar**



- Sasia: 100 copë

s. **Prodhim materiale promocionale - kapele me brandime të dedikuar**

- Kategoria: Baseball ngjyrë të bardhë
- Sasia: 100 copë
- Shembull:



t. **Prodhim kite promocionale me vegla kopshtarie**

- Secila kuti duhet të përmbajë mjete për mbjelljen e luleve:
  - 2 x etiketa mbjellëse/shënues prej druri të bimëve
  - 2 vazo me fibra fertile 100% organike, e qëndrueshme dhe e biodegradueshme
  - 1 x lopatë me brandim adesiv
  - 1 x pirun me brandim adesiv
  - 1 x bllok shënimesh me brandim
  - 1 x palë doreza kopshtarie me brandim
  - Sasia: 100 copë



u. **Prodhim materiale promocionale – spila me brandime të dedikuar**

- Diametri 30-35mm
- Sasia: 300 copë



v. **Prodhim materiale promociionale – certifikata me brandim të dedikuar**

- Formati A4 – certifikata vleresimi
- Sasia: 1000 copë

w. **Prodhim materiale promociionale – çanta beze me brandim**

- Materiali beze, ngjyra bezhë
- Përmasat 35 x 45 cm



- Sasia: 300 copë

x. **Prodhim materiale promociionale – dosje kartoni për prezantim e personalizuar**

- Materiali: Karton 16 pt
- Ngjyra e printimit: CMYK 4/0
- Dimensionet 9" x 12"
- Sasia: 300 copë
- Shembull:



y. **Prodhim materiale promociionale – kartolina me brandim**

- Përmasat: A5 e palosur për A6, CMYK 4/0, trashësia 14pt.
- Shoqëruar me zarf
- Sasia: 500 copë

z. **Prodhim materiale promociionale – bluza T-shirt me brandim**

- Bluza T-shirt, materiali pambuk, Masat S, M, L
- Sasia: 500 copë

aa. **Krijim design dhe prodhim materiale të printuara (libërth për ngjyrosje A4)**

- 10 Faqe të animuara bardh e zi, me tema nga specifikat e broshurës
- Sasia: 300 copë
- Shembull:



**ROAD SAFETY**  
Coloring Pages!



bb. **Varëse çelësash me brandim logo projekti- forma biçikletë**

- Materiali: plastike me ngjyra me logo
- Përmasat: Si në fig. në shembull
- Sasia: 1000 Copë



- Shembulli:

cc. **Prodhim dhuratë druri promocionale me gdhendje**

- Materiali dru i holle 3mm.
- Sasia: 500



- Shembulli:

- **SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimet teknike/termat e references janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat/shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë

cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat/ shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38 dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.